



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 24.10.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të datës 18 tetor 2019.
2. Miratimi i programit të punës së Komisionit për periudhën 21 tetor – 15 nëntor 2019.
3. Seancë dëgjimore me kandidaten për Komisionere të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, zonjën Pranvera Strakosha. *(Komision përgjegjës)*

**Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Elena Xhina, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Ediola Braha, Xhemal Qefalia, Edlira Bode, Elda Hoti dhe Andi Përmeti.

**Mungojnë:**

Edmond Leka, Damian Gjikhuri, Fatmir Xhafaj, Alban Zeneli dhe Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Pranvera Strakosha – Kandidate për Komisioner i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Meqenëse kuorumi plotësohet, vazhdojmë me tri çështjet që kemi në rendin e ditës.

Së pari, miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të Ligjeve i datës 18 tetor 2019.

A jeni dakord me procesverbalin?

Miratohet procesverbali i mbledhjes së datës 18 tetor 2019.

Së dyti, miratimi i programit të punës së Komisionit për periudhën 21 tetor -15 nëntor 2019. Programi i punës së komisionit reflekton programin e punës së miratuar në Kuvendin e Shqipërisë në seancë plenare.

A ka sugjerime për programin? Nuk ka.

Miratohet programi i punës së komisionit për periudhën 21 tetor-15 nëntor 2019.

Së treti, kemi seancë dëgjimore me kandidaten për Komisionere të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, zonjën Pranvera Strakosha.

Komisioni ynë është komision përgjegjës dhe relator është kolegu Alket Hyseni, i cili mbulon edhe Nënkomisionin për Administratën Publike.

Zonjën Strakosha e kemi prezente në komision. Zonja Strakosha, mirë se erdhët në Komisionin e Ligjeve!

Po jua kaloj fjalën për të prezantuar para kolegëve arsyet që ju shtojnë për të kërkuar një mandatë të dytë në krye të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil. Sipas nenit 12 të ligjit nr. 152 të vitit 2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar” Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil zgjidhet nga Kuvendi për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë.

Zonja Strakosha është zgjedhur në tetor të vitit 2014 dhe në fund të këtij tetori i mbaron mandati 5-vjeçar. Bazuar në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit, pika 3, kandidaturat për vendin vakant të krijuar pas mbarimit të mandatit të zonjës Strakosha, duhet t’i paraqiten Kuvendit 45 deri 30 ditë përpara mbarimit të mandatit. Në këto kushte, me vendimin nr. 2, datë 30.09.2019, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, e ka shpallur vakancën për pozicionin e Komisionerit të Shërbimit Civil dhe është bërë publike në faqen zyrtare të Kuvendit në datën 01.10.2019 për një afat 20-ditor. Në përfundim të afatit 20-ditor, ka shprehur interesin për këtë pozicion vetëm një kandidaturë, që është ajo e

zonjës Pranvera Strakosha. Referuar nenit 12 të ligjit, zonja Strakosha legjitimohet për të rikandiduar për këtë pozicion.

Në bazë të nenit 111 të Rregullores, Komisioni i Ligjeve, brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, shqyrton përmbushjen e kriterëve kushtetuese, ligjore dhe meritën e çdo kandidature, si dhe organizon një seancë dëgjimore me secilin nga kandidatët. Në lidhje me përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore, do të flasë më vonë kolegu Hyseni, si relator i këtij projektvendimi.

Unë do t'ia kaloj fjalën zonjës Strakosha për të bërë një prezantim të shkurtër të arsyeve që e shtynë për të kërkuar një mandatë të dytë në krye të këtij institucioni. Zonja Strakosha, do t'ju lutesha shkurtimisht, meqenëse ju e keni rikandidim, pra ky komision e ka shqyrtuar kandidaturën tuaj edhe para 5 vjetësh. Gjithsesi, fjala është për ju, për të bërë një prezantim të arsyeve që ju keni parashtruar.

**Pranvera Strakosha** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë,

Në fakt, si sot 5 vjet më parë kam qëndruar para këtij komisioni të nderuar, duke kërkuar mbështetjen tuaj për t'u zgjedhur në pozicionin e Komisionierit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, një institucion i ri i sapokrijuar, i cili për nga kompetencat, mënyra e formimit dhe funksionimit është unik, jo vetëm në Europë, por edhe më gjerë.

Përpara se të flas shkurtimisht për punën e kryer dhe për atë që mendoj të bëj në 5-vjeçarin e dytë, dua t'ju falënderoj për besimin që më dhatë për zgjedhjen në këtë pozicion, por edhe për mbështetjen që më keni dhënë gjatë 5-vjetëve të funksionimit të detyrës sime.

Në fakt, kanë qenë 5 vjet punë të palodhura, me sfida, me vështirësi të ndryshme, por, sigurisht, edhe me arritje. Duke qenë një institucion i pavarur, jam përpjekur që Komisioneri të jetë mbi palët dhe të perceptohet edhe nga të tjerët si i tillë. Duke pasur parasysh një shprehje, që e themi gjithmonë në fushën e juristëve: “drejtësia duhet jo vetëm të jepet, por edhe të duket që po jepet”. Pavarësisht se vendimmarrja e Komisionerit ka pasur dhe ka thellësisht natyrë administrative në të gjithë vendimmarrjen time kam bërë një hetim të thelluar administrativ të mbështetur në prova, të analizuar dhe të gjitha vendimet e Komisionerit kanë qenë në analizë të thellë të ligjit më shumë për të dhënë jo vetëm një zgjidhje të problematikës, por edhe mesazhin se si duhet të funksionojë dhe si duhet të zbatohet ligji.

Zgjedhja e Komisionerit në vitin 2014 përkoi me dy momente shumë të rëndësishme: me reformën në administratën publike dhe me reformën administrative territoriale. Nisur nga rëndësia, por edhe nga kompleksiteti i këtyre reformave i kemi dhënë një rëndësi të madhe ndërgjegjësimit të njësive të burimeve njerëzore në lidhje me ligjin e ri të sapohyrë në fuqi,

sidomos të pushtetit vendor, ku problematikat ishin të shumta, vështirësitë të shumta, burimet njerëzore të kufizuara si në numër dhe në njohjen shumë minimale të ligjit. Kjo ka sjellë që paligjshmëria në lidhje me ligjin të jetë më e shumtë edhe në njësitë e qeverisjes vendore. Në fakt, roli i Komisionerit ka filluar të rritet në këta 5 vjet dhe unë e shikoj në tri momente kryesore.

Së pari, në rritjen e kërkesave dhe ankesave apo të denoncimeve të bëra nga nëpunës civil për shkelje ose paligjshmëri të kryera nga njësitë e burimeve njerëzore.

Janë shqyrtuar rreth 450 kërkesa, vendimmarrja e të cilave nuk është atakuar asnjëherë në gjykatë nga palët, por është pranuar si e tillë: kërkesat për interpretim që kanë ardhur qoftë nga Departamenti i Administratës Publike, qoftë edhe nga vetë nëpunësit civilë për momente të caktuara apo dispozita të caktuara të ligjit; kërkesat për t'u njohur me gjetjet e Komisionerit apo edhe vlerësimet e marra nga institucionet ndërkombëtare, sidomos gjatë dy momenteve kryesore: të monitorimit të sjelljes së nëpunësit civil gjatë fushatave zgjedhore të viteve 2017 dhe 2019.

Në fakt, një nga arritjet tona të vitit të fundit është edhe...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zoti Fino, me të drejtë ndërhyjni, por, në fakt, mund ta kishit kërkuar fjalën edhe për procedurë, cilat janë arsyet pse kërkonti një mandat të dytë? Çfarë është bërë, cila është veprimtaria juaj në krye të Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil ju i keni raportuar në komision, i keni raportuar edhe në seancë plenare. Zoti Hyseni, si relator, do t'i vërë në dukje meritat e punës suaj në krye të këtij institucioni. Pra, cilat janë arsyet pse kërkonti një mandat të dytë?

Fjala është për ju.

**Pranvera Strakosha** - Mendoj se eksperiencia e këtyre 5- vjetëve do të më ndihmojë shumë në ecjen dhe në çuarjen përpara të reformave që kemi nisur dhe të vazhdimësisë së punës si Komisionere.

Së pari, në zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ku jemi duke përmbyllur fazën e dytë dhe do të fillojmë fazën e tretë. Faza e dytë ka qenë frytdhënëse, pasi institucionet kanë filluar t'i zbatojnë vullnetarisht vendimet gjyqësore dhe ajo do të paraqitet para këtij komisioni të nderuar, me një raport të posaçëm, por ne do të vazhdojmë në fazën e tretë që të përmbylлим ekzekutimin 100%.

Kemi filluar diskutimet me DAP-in që ta shtrijmë procesin e rekrutimit *online* edhe në njësitë e qeverisjes vendore. Dëshiroj që të marr edhe një mandat të dytë, sepse jemi në fillimet e këtij projekti. Produktin do të na i japë të gatshëm Departamenti. Tani jemi duke diskutuar

modalitetet se si ta shtrijmë në njësitë e qeverisjes vendore dhe do të vazhdojmë me stabilizimin e strukturave.

Kemi shumë problematika në njësitë e qeverisjes vendore. Në muajin shtator kemi inspektuar të gjitha bashkitë dhe do të fillojmë të merremi me strukturimin e tyre. Kam parë struktura shumë të gabuara, po lodhemi shumë, por themi se do t'ia arrijmë qëllimit.

**Ulsi Manja** – Pra, një nga arsytet : është vazhdimi i punës deri në fund. Pra, nuk e keni mbyllur ende misionin në krye të këtij institucioni?

**Pranvera Strakosha** – Po.

**Ulsi Manja** - A ka arsye të tjera?

**Pranvera Strakosha** – Ashtu si në mandatin e parë, do të përpiqemi që të kryejmë me një lartësi dhe me një korrektesë zbatimin e ligjit, në mënyrë që të aftësojmë njësitë e qeverisjes vendore që të mos gabojnë në zbatimin e ligjit. Problemi nuk është të gjejmë gabimet, por të mos i lëmë që të gabojnë.

**Ulsi Manja**- Faleminderit, zonja Strakosha!

Zoti Hyseni, ju lutem, na thoni diçka në lidhje me përmbushjen e kushteve, kriterëve ligjore dhe të meritës së kandidaturës që kemi sot në komision.

**Alket Hyseni**- Faleminderit, zot kryetar!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

E nderuar komisionere,

Të nderuar të ftuar dhe dëgjues,

Kam kënaqësinë që të jem relator në një kandidim të një zyrtari, i cili zgjidhet nga Kuvendi, që ndryshe nga shumë të tjerë ka përmbushur të dyja anët e medaljes: së pari, nga pikëpamja formale e kërkesave që ligji përcakton, unë ftoj secilin nga anëtarët që mund të konsultojë dokumentacionin e paraqitur nga zonja Strakosha, i cili është jo thjesht në përputhje me kërkesat, por është në tejkalim të këtyre kërkesave. Zonja Strakosha ka një CV të shkëlqyer profesionale dhe ka një formim arsimor shembullor, madje bashkë me kryetarin nuk konstatoam asnjë notë 9 në rezultatet historike të saj, por të gjitha 10; së dyti, ka një karrierë të spikatur edhe profesionale si juriste, si avokate dhe si gjyqtare, pra në tre komponent. Përveç kësaj, kërkesat e tjera formale janë të plotësuara dhe ka paraqitur të gjitha dokumentet e kërkuara nga njoftimi i Kuvendit, i cili bazohet në kërkesat e ligjit për nëpunësin civil, në të cilin përcaktohen kriteret që duhet të përmbushë komisioneri, ku, përveç kriterëve të nëpunësit të administratës, që janë kriteret e përgjithshme, nëse doni mund t'jua lexoj, ka vjetërsi në punë mbi 10 vjet, që është kriter skualifikues, nuk ka asnjë rekord penal problematik apo masë disiplinore në të kaluarën duke qenë se nuk ka qenë punonjëse e administratës publike. Dy

verifikime, të cilat janë detyrë e Kuvendit në zbatim të ligjit, qoftë nga prokuroria për sa i takon formularit të vetëdeklarimit që ka plotësuar zonja Strakosha si kandidaturë e vetme, e tha edhe kryetari që kjo është kandidatura e vetme e paraqitur, qoftë edhe nga Autoriteti për Informimin e Dokumenteve të ish-Sigurimit, janë procedura në kryerje e sipër dhe, në bazë të pikës 2 të vendimit të Kuvendit, procedura e verifikimit nuk pengon vijimin e procedurave për zgjedhje. Pra, nëse ata do të vijnë do t'ia bëjmë me dije menjëherë komisionit dhe Kuvendit. Verifikimi ka kohë, sepse kjo është faza e parë e dëgjësës dhe pas kësaj faze është mbledhja e firmave të 28 deputetëve për t'ia përcjellë Kuvendit. Nëse do të kenë ndonjë gjë kur të vijë përgjigjja e verifikimit, që besoj se nuk do të ketë, do t'ia bëjmë me dije komisionit dhe do të jetë vendimarrja e tij. Përveç kriterëve formale, që zonja Strakosha i plotëson, unë, edhe në cilësinë e nënkryetarit të Komisionit të Administratës Publike, mund t'ju them se në 5 vjetët e ushtrimit të detyrës, nuk e thashë kot si jokushdo nga zyrtarët e zgjedhur nga Kuvendi, ky komisioner...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Fino, jam edhe në cilësinë e nënkryetarit dhe po bëj edhe diskutimin...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Detyra e relatorit është të tregojë të vërtetën, pastaj vendimarrjen e keni ju në dorë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Relatorit i takon të thotë të vërtetën dhe mbi bazën të saj të merret vendimi.

Zoti Fino, deri para 5 vjetëve nuk e dinte njeri që ekzistonte Komisioneri për Administratën Publike...

**Bashkim Fino**- Na thuaj nëse është në rregull CV-ja. Kaq.

**Alket Hyseni** –Atë e thashë unë, por do të them edhe tjetrën, sepse është detyrë imja.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti kryetar, dispijlojeni kolegun!

**Ulsi Manja** – Zoti Fino, ju lutem, lëreni të mbarojë zotin Hyseni dhe të mbyllim seancën.

**Alket Hyseni** – Ajo ka bërë një punë të lavdërueshme. A është ideale?! Ideale s'është asnjëherë dhe komisionerja e tha vetë që ka shumë punë për të bërë, prandaj ajo mendon se, duke qenë se ka shumë punë për të bërë, kërkon edhe një mandat të dytë, sepse mund ta ushtrojë profesionin në disa drejtime të tjera. Prandaj, unë them që ta mbështesim këtë kandidaturë. Ne nuk do ta votojmë tani, por ftoj të gjithë anëtarët që në fokus të kriterëve formale të plotësuar, të tejkaluara dhe të punës së bërë në 5 vjetët e kaluara, t'i mundësojmë zonjës Strakosha edhe

një mandat tjetër në krye të atij institucioni të rëndësishëm, i cili ka bashkëpunuar me Kuvendin dhe me këtë komision, këtë nuk duhet ta harrojmë, në mënyrë korrekte.

Faleminderit!

**Ulsi Manja-** Faleminderit, zoti Hyseni!

Dua t'u sjellë në vëmendje kolegëve të komisionit që, bazuar në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni i Ligjeve vlerëson përmbushjen e kushteve, kriterëve ligjore dhe meritën e kandidaturës në përputhje me ligjin dhe, pas miratimit të raportit së bashku me kandidaturën ua përcjellë grupeve parlamentare respektive në Kuvendin e Shqipërisë. Kandidatura e zonjës Strakosha duhet të mbështetet, bazuar në nenin 111, pika 1, të Rregullores, me 28 firma deputetësh dhe më pas i kalon seancës plenare.

Detyra e këtij komisioni sot është nëse kandidatura e zonjës Strakosha, që e kemi sot në seancë dëgjimore, plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligjin nr.152 të vitit 2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar". Vlera e kësaj seance dëgjimore është që të krijojë bindjen te deputetët, të cilët do ta votojnë në seancë plenare, se kemi të bëjmë me një kandidaturë dinjitoze për të drejtuar edhe për 5 vjetët e ardhshëm Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil.

Zoti Hyseni bëri një ekspozitë të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore. A ka pyetje nga kolegët për zonjën Strakosha?

Po, zoti Alimadhi.

**Adriatik Alimadhi-** Në fakt, unë dua të falënderoj dy kolegët e pozitës, të cilët kryejnë rolin edhe të pozitës edhe të opozitës, zotin Fino dhe zotin Hyseni, dhe nuk e kanë të nevojshme pjesëmarrjen tonë këtu!

Në dokumentin që ka ardhur nga sekretari i Përgjithshëm dhe që është publikuar në faqen zyrtare shoh që nuk ka treguar interes asnjë kandidaturë tjetër. Nuk e di nëse kjo është e saktë dhe e drejtë, por unë e marrë të mirëqenë. Prandaj, përderisa kemi një kandidaturë të vetme, unë, personalisht, mendoj se i plotëson të gjitha kriteret. Duke dëgjuar edhe relatorin, i cili na tregoi edhe rezultatet e zonjës, jap pëlqimin tim për të vazhduar procedurat.

Faleminderit!

**Ulsi Manja-** Faleminderit, zoti Alimadhi!

A ka pyetje nga kolegët e tjerë? Nuk ka.

Përpara se të hedhë kandidaturën në votim, dua t'ju them se unë bashkohen me atë që tha zoti Hyseni, se dosja e kandidates, zonjës Strakosha, që na është vënë në dispozicion, është e plotë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit për shërbimin civil. Unë e thashë edhe në fillim të fjalës time që kemi të bëjmë me një rikandidim, ku zonja Strakosha para 5 vjetëve ka kaluar në

këtë komision dhe në seancë plenare. Unë bashkohem me mendimin e të gjithë kolegëve të tjerë që bashkëpunimi me zonjën Strakosha në krye të Komisionit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil gjatë këtyre 5 vjetëve ka qenë korrekt dhe, natyrisht, në përputhje me ligjin. Edhe unë jam dakord me atë që u tha, se puna e mirënisur në atë institucion duhet të çohet deri në fund. Jemi në fazat e para të konsolidimit të një administrate të shërbimit civil dhe, pse jo, eksperiencia e zonjës Strakosha në krye të këtij institucioni do të jetë një vlerë e shtuar.

Kush është dakord me raportin me kandidaturën e zonjës Strakosha për t'ua kaluar grupeve parlamentare dhe më pas seancës plenare për një mandat të dytë në krye të këtij institucioni? Kundër nuk ka. Asnjë abstenim.

Miratohet raporti me kandidaturën e zonjës Strakosha, e cila i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj. Relatori dhe këshilltarët të bëjnë gati raportin dhe t'ua përcjellin sot të gjitha grupeve parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë dhe deputetëve të pavarur, të cilët, në bazë të nenit 111, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, kanë të drejtën të mbështesin propozimin e zonjës Strakosha me 28 firma.

Me këtë seancë dëgjimore e mbyllim sot mbledhjen e Komisionit të Ligjeve. Mbledhja e radhës do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Shumë faleminderit dhe ditë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**